

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 10.01.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.01.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rahovica Commerce SHPK" për aktivitetin: "Implementimi i planit të mobilitetit-Rikonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6284-511 nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Rahovica Commerce SHPK" e datës 03.01.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i planit të mobilitetit-Rikonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6284-511 kundër *Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 15.11.2019*, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. **Vertetohet** *Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 31.12.2019*;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Rahovica Comerc SHPK" me datë 03.01.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimi i planit të mobilitetit-Rikonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6284-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 10.01.2020 dhe ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimi juaj lidhur me faktin se i njejt tenderues eshte shpallur njehere si i pa pergjegjshem, ndersa heren tjeter si fitues ka te beje kryesisht me pretendimet tuaja nga kerkesa e mepame per rishqyrtim, sipas te ciles eshte verifikuar se Deklarata doganore e dorezuar per makine sperkatese per emulsion ka qene Deklarate e eksportit dhe ne baze te

kesaj ai tenderues eshte eliminuar. I njejt ka paraqitur kerkese per rishqyrtim duke sjell per deshmi nje Deklarate tjeter doganore sipas te ciles rezulton se mjeti qe i eshte derguar kompanise ne Maqedoni eshte kthyer prap ne gjendje te rregullte ne Kosove dhe se tani eshte ne bazen e OE-ik me te cilen e ka marreveshjen per shfrytezim te makinerise-“Eskavatori Company”. Pastaj ju ne kerkesen tuaj e keni kontestuar edhe kete dokument duke deklaruar se eshte pjese e atij dokumenti paraprak dhe eshte nje mashtrim. Per kete arsye si qe ju kemi njoftuar paraprakisht ne kemi tentuar te verifikojme pretendimet tuaja dhe te tenderuesit tjeter duke vizituar kompanine “Eskavatori Company” dhe dokumentet e dorezuara nga tenderuesi “Alfa I”. Verifikimin per kete se pari e kane bere komisioni i rivleresimit e qe sipas jush nuk paraqet asnje deshmi per mjetin e kontestuar. Per kete arsye kam autorizuar dy zyrtare nga Departamenti i Prokurimit te cilet me daten 09.01.2020 kane vizituar seline e kompanise “Eskavatori Company” dhe kane verifikuar se dokumentet e dorezuara perputhen teresisht me dokumentet origjinale te OE-ik dhe se ne bazen e te njejt gjindet mjeti qe ju e keni kontestuar.

Bazuar ne gjendjen faktike te verifikuar nga zyrtaret tane konstatoj se ky pretendim eshte i pa bazuar.

Pretendimi tjeter se OE-ik “Eskavatori Company” nuk ka te drejte ligjore qe te jete me nje tenderues si anetar i konzorciumit dhe qe me nje tenderues tjeter te kete marreveshje per dhenjen e mjeteve ne shfrytezim poashtu eshte i pa bazuar, pasi qe ne rastin e dyte kemi te bejme vetem me nje marreveshje per dhenjen ne shfrytezim te mjeteve e qe kete nuk e bene as anetar e as nekontraktor per tenderuesin “Alfa I”.

Bazuar ne konstatimet paraprake konstatoj se aktiviteti duhet te vazhdoj sipas Njoftimit te dates 31.12.2019.

Shtese: Bashkengjitur fotoja e mjetit e dates 09.01.2020 nga baza e “Eskavatori Company”.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



